REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr.2276/Prot.
/13

Pogradec, më 30. 05. 2024

VENDIM

NR. 56, DATË 28.05.2024

# MIRATIMI I PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 30.04.2024 TË KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC

Këshilli I Bashkisë Pogradec në mbledhjen e tij të datës së sotme,pasi lexoi proces-verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes së datës30.04.2024, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k si dhe neni 92 e Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec miratuar me VKB nr 40, datë 05.03.2020.

KËSHILLI I BASHKIAK

VENDOSI:

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Pogradec , të datës 30.04.2024 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

1.Miratuar me 23 vota

2.Vota Pro 23

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 0

5.Zbardhur më date 30.05.2024

Mbledhje e Këshillit Bashkiak Pogradec më ___.___. 2024

ORA : 12 : 00

JANË PREZENT 20___ KËSHILLTARËPROTOKOLLI I MBLEDHJSES SË KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC DATE 30.04.2024 ME KËTË REND DITE.

1.Projekt – Vendim : Miratimi i Rendit të ditës.

2. Projekt – Vendim: Miratimi i Procesverbalit të datës 30.04.2024.

3. Projekt – Vendim:Per nje rishperndarje ne VKB nr .140 dt 28.12.2023"Per miratimin dhe detajimin e buxhetit te Bashkise Pogradec per vitin 2024"

Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më ___.___. 2024

1.Projekt – vendim :Miratimi I Rendit të ditës.

Diskutime

M. Kamolli: Ju falenderoj për prezencën tuaj.
Hapim sot mbledhjen e jashtë radhës e thirrur nga Kryetari i Bashkisë z. Xhakolli.
Vazhdojmë me prezencën.
Janë 20 anëtarë prezent.
Ju ftoj të hedhim në votim rendin e ditës.

U votua

Pro 20

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet (Po) Jo

Miratohet pika nr. 1. e rendit të ditës me 20 vota pro.

Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më ___.___. 2024

2. Pika nr 2 : "Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 30.04.2024 të Këshillit Bashkiak Pogradec" .

M. Kamolli: Pika nr 2 e rendit të ditës, është miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 30.04.2024 të Këshillit Bashkiak Pogradec.
E keni parë, e keni firmosur ndaj ju ftoj të hedhim në votim.

U votua

Pro 20

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet (Po) Jo

Miratohet pika nr. 2 e rendit të ditës me 20 vota pro.

Mbledhje e KëshillBashkiak Pogradec më ___.___. 2024.

3.Pika nr :.Për një rishpërndarje në VKB nr.140 dt 28.12.2023 "Për miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për vitin 2024"

Diskutime

M. Kamolli: Vazhdojmë me projekt - vendimin për të cilën jemi mbledhur.
Financa ka bërë ndryshimet e saj, ne i kemi përpara, nëse ka gjëra të tjera ju lutem t'i diskutojmë.
F. Pikuli: Unë dua të di çfarë ka ndryshuar pas aprovimit të buxhetit në 28.12.2023 deri tani.
Pse kjo shumë ndryshoi nga 6 milion u bë 9 milion!
D.[illegible]: Tani ka ardhur parashikimi më i detajuar dhe janë bërë llogaritjet, ndaj ndryshoi edhe buxheti.
M. Shuli: Në komisionin e djeshëm ishte specialisti i pyjeve dhe e shpjegoi që ky 6 milionësh ka qenë parimi kur u hartua buxheti, tani për gjërat e specifikuara u desh të rritej.
D. Qirko: Në këto gjëra që mendohet të vilen të ardhura nuk ka shpejtësi vetëm tregje.
C. Hadhillari: Duhet të kemi parasysh që kur bëhet planifikimi i buxhetit, të kemi një bashkëpunim të mirë mes dy drejtorive që mos ndodhin këto situata.
K. Lugo: Mbështes se janë bashkuar dy drejtoritë në fund të vitit ne kemi disa objektiva të cilat duhet t'i përmbushim.
Dhe kur është planifikuar buxheti nuk ka qenë i detajuar, ndërkohë që tani kemi parashikimin tonë, prandaj kemi rakorduar ~~parashikimin~~ buxhetin sipas parashikimit.
F. Pikuli: Sa kohë është ky emision? Të gjitha këto hektarë toke bëhet të mjaftoj zgjidhja? Sepse po kemi të njëjtën kosto. Unë bëj thirrje të rishikohet parashikimi
K. Lugo: Nga VKM thotë që në vitin 1985 është bërë akordimi i përgjithshëm. Unë nuk i ndryshoj dot këto klasë masive. Unë mori regjistrin e vjetër sepse këto kam.
F. Pikuli: Kjo nuk është përgjegjësia jote, por e specialistit që e ka bërë.
M. Kamolli: E hedhim në votim, i ftoj pikën 3. të rendit të ditës
U votua [illegible] Shyti

A. Prifti.

Pro 20

Kundër 1 F. Pikuli

Abstenim 1 M. Biba

Miratohet (Po) Jo

Miratohet pika nr. 3. e rendit të ditës me 20 vota pro

M. Kamolli: Duke ju falenderuar mbledhjen e deklaroj të mbyllur.
Protokolloi: Matilda Tollaku